



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:243632

Datë: 22.10.2024

Numri i dokumentit: 06331294

C.nr.656/2019

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 22.10.2024, në GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil në çështjen juridike të paditëses KEP Trust të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.D. kundër të paditurve F.Xh. dhe Sh.S. , me objekt kontesti pagesë e borxhit nga marrëveshja mbi kredinë.

P r e z e n t:

Gjyqtari:
Leotrim Gashi

Për paditësen
L.D. sipas autorizimit

Për të paditurit:

1. F.Xh.
2. Sh.S.

Zyrtare ligjore
Liridona Bajrami

Pyeten palët se a kanë vërejtje në përbërjen e gjykatës:

Pa vërejtje nga palët.

Seanca është publike

Filloj ne ora : 10:00.

Gjyqtari i çështjes e hap shqyrtimin mbi këtë çështje, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në këtë seancë prezent është përfaqësuesi i autorizuar i paditëses L.D. dhe të paditurit F.Xh. dhe Sh.S. .

Andaj gjykata konstaton se ka kushte ligjore për mbajtjen e seancës, e si rrjedhojë merr:

A K T V E N D I M

Seanca e sotme mbahet dhe e njëjta është publike.

Gjykata i njofton palët prezente se duhet të mbajnë rendin dhe qetësinë në gjykatë dhe nuk duhet të flasin derisa gjykata të iu jap fjalën, për prishje të rendit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, gjykata mund që duke u bazuar në nenin 289.2 të LPK-së, fillimisht do t'i qortojë palët dhe nëse kjo rezulton të jetë e pasuksesshme mundet që ti largoj nga salla dhe t'iu shqiptojë gjobë deri në 500 euro.

Gjykata i njofton palët së në këtë seancë përgatitore duhet të parashtrojnë të gjitha faktet në të cilat mbështesin kërkesat e tyre si dhe të propozojnë të gjitha provat më të cilat pretendojnë të vërtetojnë faktet e tilla.

Gjykata i njofton palët se kontestin mund ta zgjidhin edhe në procedurën e ndërmjetësimit, në pajtim me nenin 411 të LPK – së si dhe me anë të pajtimit gjyqësor siç parashihet në nenin 412 të LPK – së.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo pajtimit gjyqësor, përfaqësuesi i paditësit, deklaron:

Ne me të paditurit para se të vijmë në këtë seancë jemi dakorduar që të arrijmë një marrëveshje gjyqësore, ashtu që të paditurit nga muaji i ardhshëm Nëntor 2024, në mënyrë solidare do të paguajnë nga 100 euro në muaj deri në përfundimin e detyrimit si dhe taksën në shumën prej 30 euro.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo pajtimit gjyqësor, i padituri F.Xh. deklaron:

Pajtohem me deklarimin që e dha përfaqësuesi i paditëses që ne të arrijmë marrëveshje gjyqësore.

Lidhur me mundësinë e zgjidhjes së këtij kontesti përmes procedurës së ndërmjetësimit apo pajtimit gjyqësor, e padituri Sh.S. deklaron:

Pajtohem me deklarimin që e dha përfaqësuesi i paditëses që ne të arrijmë marrëveshje gjyqësore.

Përfaqësuesi i paditëses kërkon fjalën dhe deklaron se:

Pas vonesës së pagesës së borxhit edhe pas paraqitjes së padisë, detyrimi i të paditurve është rritur për shkak të kamatës dhe është ndalur në shumën prej 1500.51 euro, për të cilën jemi dekoduar me të paditurit, andaj në këtë seancë e precizojmë kërkesëpadinë ashtu që, kërkojmë nga gjykata të paditurit në emër të pagimit të borxhit për kredinë të ia paguajnë paditëses shumën prej 1500.51 euro.

I padituri F.Xh. lidhur me precizimin e bërë nga përfaqësuesi i paditëses deklaron:

Nuk e kundërshtoj ndryshimin e padisë.

E paditura Sh.S. lidhur me precizimin e bërë nga përfaqësuesi i paditëses deklaron:

Nuk e kundërshtoj ndryshimin e padisë.

Gjykata merr;

A K T V E N D I M

LEJOHET ndryshimi i padisë së datës 19.09.2019, ashtu që kërkesëpadia e paditëses me të cilën ka kërkuar nga të paditurit që ta kthejnë borxhin është në shumën prej 1500.51 euro.

Palët ndërgjyqëse deklarojnë se kanë arritur pajtim gjyqësor dhe i propozojnë gjykatës që ta aprovojë këtë:

PAJTIM GJYQËSOR

- I. DETYROHEN të paditurit F.Xh. dhe Sh.S. , që në mënyrë solidare, në emër të borxhit për kredi të datës 21.10.2016, të ia paguajnë paditëses shumën prej 1500 euro, të cilën shumë duhet ta paguajnë nga 100 në muaj për 15 këste dhe atë duke filluar nga muaji Nëntor 2024 deri në përfundim të përmbushjes totale të detyrimit, e cila

shumë duhet të paguhet në cilëndo nga degët e bankës KEP Trust ne Republikën e Kosovës nga data 01 – 05 të çdo muaji vijues (kësti).

- II. DETYROHEN të paditurit në mënyrë solidare që të ia paguajë paditëses taksën për padi në shumë prej 30 euro, e cila pagesë duhet të bëhet në kështin e 15, si në dispozitivin I. të kësaj marrëveshje.

Gjykata në bazë të nenit 411 dhe 412 të LPK –së, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pajtimi gjyqësor, i lartpropozuar nga ana e palëve ndërgjyqëse.
- II. Ky pajtim paraqet titull ekzekutiv dhe mund të goditet vetëm me padi.

Procesverbali pasi u dëgjua me zë i njëjti edhe u nënshkrua pa vërejtje.

Përfundoi në ora: 10:25 minuta.

Përfaqësuesi i paditëses

Të paditurit

- 1.
- 2.

V ë r t e t o j n ë

Zyrtarja ligjore

Gj y q t a r i